

MENAXHIMI I DREJTË I POLITIKAVE FISKALE - ÇELËS I SUKSESIT EKONOMIK

*Dr. Artan Nimani, ass.
artannimani@gmail.com*

Abstrakti

Objekti, kuptimi, rëndësia dhe përkufizimi i tatimeve dhe veçmas i tatimit në vlerën e shtuar në teorinë dhe praktikën tatimore si dhe domosdoshmëria e shkallëzimit të saj është synim im në këtë punim. Nisur nga fakti se sistemi tatimor nuk zhvillohet në kushte të njëjta në të gjitha vendet, atëherë në këtë punim do të shtjellohen elemente të veçanta të shteteve në BE dhe do të behët krahasimi i tyre me Kosovën, duke i kushtuar rëndësi të veçantë shkallës tatimore dhe vet TVSH që nga momenti i aplikimit të saj dhe deri të nevojë imediate për shkallëzim. Arsyeja ynë kryesore për t'iu qasur kësaj problematike është se tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh) është risia e katër dekadave të fundit në sistemin tatimor të shumë shteteve të zhvilluar dhe atyre në zhvillim. Kosova është një ndër shtetet me të reja që e aplikon një sistem të moderuar tatimor duke u bazuar në modele të sistemeve më të avancuara botërore dhe kjo siguron që është duke ecur drejt sistemit në radhët e sistemeve tatimore të BE-së. Rëndësia dhe roli që kanë të hyrat publike në zhvillimin ekonomik të çdo shteti është edhe shkaku kryesor për njohjen e problematikës të sistemit të hyrave dhe funksionimit të organeve shtetërore krahas grumbullimit të këtyre të hyrave. Kjo problematikë është njëra ndër vështirësitë më të mëdha që paraqiten në shumë shtete si për obliguesit tatimor ashtu edhe për organet që i administrojnë të hyrat, këto vështirësi theksohen sidomos në shtetet që janë në zhvillim siç është rasti i Kosovës.

Fjalë kyç: TVSH, Taksa, Politika fiskale, evazioni, BE

JEL klasifikimi: G,G1,G18.

Hyrje

Menaxhimi i Politikave fiskale - çelës i suksesit ekonomik, kjo ishte fjalja e parë që më asocoj në momentin e fillimit të këtij punim sepse të gjitha analizat me shpinin në këtë përfundim.

Shpesh herë politikat fiskale janë ato që e ngritin një “perandori” dhe zhdukun pastaj si pasojë e gabimeve të vogla brenda sistemit të madh që ne po e quajmë Politik fiskale. Menaxhim i drejtë i tyre është obligim qytetar dhe kombëtar i secilit që në duar ka paratë e popullit, që i a ka besuar për të qeverisur. Sot kur bota kryesisht është e orientuar në ekonominë e hapur të tregut edhe financat publike duhet të operojnë në këtë vijë perderisa menaxhimi i tyre e përcakton ardhmërinë e atij vendi.

Në kushtet e ekonomisë së hapur ndaj rrjedhave të kapitalit, menaxhmenti i politikës fiskale bëhet më i vështirë. Vendet që i nënshtrohen procesit të globalizimit ballafaqohen me pasiguri të shumta që lidhen me madhësinë, shpejtësinë dhe kohen e mundshme të rrjedhave të kapitalit. Masa e efekteve negative në rrjedhat ekonomike të vendit varet nga madhësia e ekonomisë dhe roli që u është dhënë instrumenteve të politikave makroekonomike për kontrollimin e kapitalit¹³.

Komponentët e politikës fiskale, taksat dhe programet e shpenzimeve publike, u shërbejnë qëllimeve të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore të cilat mund të vihen në rrezik po qe se janë të nevojshme përshtatjet kuantitativisht të gjera për afate të shkurtra. Me disa variabla fiskale është vështirë të manipulohet në mënyrë fleksibile për periudha afatshkurtra, meqë kjo mund të rezultojë me kosto të lartë të transaksionit dhe krijon shtrembërime në alokacionin dhe rishpërndarjen e resurseve.

Nëse vlerësimet shpijnë në përfundim se reagimi fiskal është i pashmangshëm, atëherë duhet vënë në përdorim komponentët e politikës fiskale të cilat mendohen të jenë më fleksibile, më efektive, dhe krijojnë më pak shtrembërime se të tjerat. Në këto kushte, rëndësi të veçantë ka identifikimi dhe ndarja e funksioneve bërthamore në strukturën fiskale, proces i cili vështirësohet nga fakti i definimit të kësaj “bërthame”¹⁴.

Në vazhdim do të paraqesim TVSH si kampionin politikës fiskale dhe të gjitha përparësitë, mangësitë dhe efektet që reflekton ky lloj tatimi në efikasitetin dhe menaxhimin real dhe efikas të një koncepti transparent dhe mirësiillshëm për qytetarin

E kjo na shpie në drejtimin e hapjes ndaj rrjedhave të kapitalit që kushtëzohet paraprakisht me ndërtimin e një disipline të brendshme për drejtimin e politikës fiskale, disiplinë kjo që sigurohet me vënien e rregullave të cilat mbështeten në principet e politikës fiskale e që konsistonte me rregullat e ndërtuara për menaxhim të një politike të matur fiskale.

Tatimi dhe historiku i tij

“Ekziston një lidhje natyrale ndërmjet të mirës së përbashkët nga njëra anë dhe strukturës e funksionimit të autoritetit publik në anën tjetër. Rregulli moral, i cili ka nevojë për autoritetin publik për të promovuar të mirën e përbashkët në shoqërinë njerëzore, kërkon gjithashtu që autoriteti të jetë efektiv në sigurimin e rezultatit” Papa Johan XIII

Që në kohët e hershme, në kohën kur organizimin shoqëror ishte i paorganizuar, njerëzimi jetonte në fise dhe shumica e fiseve jetonin pa mbikëqyrje të ndonjë sundimtari apo mbreti u paraqit nevoja e organizimit dhe e mbrojtjes së

¹³ Florije Govori, 2005. “Menaxhmenti i politikës fiskale në ekonomitë e hapura,” Finance 0505019, EconWPA.

¹⁴ Po aty

banorëve dhe pasurive të tyre, pra u paraqit nevoja e krijimit të shtetit dhe qeverisë së tyre¹⁵.

Që nga viti 1030 para Krishti, kur fiset Izraeli jetonin pa qeveri, Bibla tregon se si njerëzit i kërkuar profetit Samuel që të “na bëjë një mbret që të na gjykojë si të gjitha kombet”. *Samueli u përpoq të ua kthente mendjen Izraelitëve duke u treguar se si ishte jeta në një monarki, ku ai përmendi se si Mbreti do të marrë, djemtë për shërbim dhe luftë, vajzat për punë në kuzhina dhe furrat e bukës së tij, fushat, ullishtat dhe të dhjetat e kopeve dhe do të vijë dita që ju do të qani për shkak të mbretit tuaj, të cilin ju vetë e zgjodhët, përfundon citati i Samuelit*¹⁶. Fragmenti nga Bibla ilustron nevojën e vjetër mbi qeverinë me funksion të dyfishtë. Qeveria është një domosdoshmëri – në fund të fundit “ të gjitha kombet e kanë atë-por në të njëjtën kohë ekzistenca e saj ka aspekte të padëshirueshme. Këto ndjenja të kundërta mbi qeverinë janë të lidhura pazgjidhshmërisht me aktivitetin e saj mbi mënyrën e të tatuarit dhe atë të shpenzimeve.

Tatimet kanë një histori të lashtë që nga koha e Egjiptit të Lashtë. Faraonet me anë të skribeve siç i quanin ata targambledhësit kishin vendosur një taksë mbi vaj gatimi. Në kohë lufte athinasit kishin vendosur një taksë të referuara si eisphora. Askush nuk ishte i përjashtuar nga taksa e cila ishte përdorur për të paguar për shpenzime të veçanta të kohës së luftës.

Kur burimet e tjera janë fituar nga përpjekjet e luftës burimet janë përdorur për rimbursim tatimor. Athinasit vendosën një taksë mujore sondazh mbi të huajt, njerëzit të cilët nuk kanë si një Nënë athinas dhe Atit, nga një dhrahmi për burrat dhe një gjysmë dhrahmi për gratë.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar – TVSH

Tatimi mbi vlerën e shtuar apo TVSH-ja është një tatim mbi konsumin. TVSh e vërtetë gërthen një rang të lirimeve (përfashtimeve) dhe diçka të ngjashme që do të minonte produktivitetin e të hyrave nga tatimi

Është e vërtetë që TVSh krijon shpenzime substanciale në inkasim por mbetet shumë e suksesshme në të gjitha vendet ku aplikohet, dhe është një pajtim i përgjithshëm se shpenzimet e vjeljes janë me të ulëta në vende ku TVSh është e thjeshtë me një shkallë të vetme dhe prag të lartë.

Praktikat e vendeve të zhvilluara tregojnë se TVSh kushton me pak se tatimet në të ardhura, por vihet në dilemë fakti se a kushton me pak se format tjera të tatimit në shitje dhe në veçanti sesa tatimet që i ka zëvendësuar dhe për këtë çështje është bërë një krahasim për gjashtë vendet Frankofone dhe gjashtë vendet Anglofone të Afrikës dhe bëhet e qartë se paraardhësit e TVSh-së ishin shumë larg asaj që të mblidhen lehtë.

Duhet përmendur suksesin e dallueshëm të tatimit, me shembullin se vetëm pese vende kanë hequr ndonjëherë TVSh-në ekzistuese.

¹⁵ Menaxhimi i Financave Publike, Artan Nimani/ ISRN/ Prishtinë 2007

¹⁶ Financa Publike (Public Finance) Harvey S. Rosen, Department of Economics Princeton University

Natyrisht rezultatet e funksionimit do të reflektojnë në faktin se ato janë të bazuara në TVSh-në që është implementuar në praktikë sesa ndonjë TVSh ideale. TVSh e vërtetë ngërthen një rang të lirimeve (përrjashtimeve) dhe diçka të ngjashme që do të minonte produktivitetin e të hyrave nga tatimi.

TVSH armiku i Ekonomisë se Zezë

Po, është e vërtetë! TVSH-ja është e thjeshtë, me kosto të lirë për t'u mbledhur, pasi nuk ka kompleksitet në funksionimin e saj. Ajo e paraqet strukturën e çmimit me një transparencë të lartë, gjë që inkurajon efektivitetin ekonomik.

Vlera e Shtuar në vetvete nuk është tjetër veçse shuma e gjithë pagave, interesave të paguara për kapitalin e vënë në punë, qiratë e ndryshme të paguara për pronën e shfrytëzuar, si dhe fitimi që rezulton nga aktiviteti. Të katër këto elemente, të shpërndara në mënyrë jouniforme te tatimpaguesit, përbëjnë atë që quhet Vlerë e Shtuar. Informacioni prej shumë administratave ka treguar se ky lloj tatimi garanton më shumë të ardhura tatimore në buxhetin e shtetit dhe ndikon më pak në zinxhirin e aktiviteteve ekonomike.

Karakteristikat dhe elementet e TVSh-së

Karakteristikat kryesore të TVSh-së janë :

- TVSh-ja është futur në pajtueshmëri me llogaritjen e tatimit në të gjitha fazat e qarkullimit sipas metodës së zbritjes, kështu që tatimi i llogaritur paguhet në çdo fazë të ciklit çarkullues d.m.th çdoherë që të mirat ose shërbimi kalojnë prej një faze në fazën tjetër të qarkullimit paguhet vetëm tatimi mbi shumën e vlerës së shtuar në fazën e fundit.
- Obliguesi tatimor i TVSh-së e cakton obligimin për pagesën e tatimit duke e zvogëluar obligimin tatimor për shumën e tatimit të llogaritur mbi vlerën e shtuar gjatë furnizimit të prodhimeve dhe të shërbimeve ose gjatë importimit të mirave domethënë se TVSh-ja bazohet në mekanizmin e faturave tatimore dhe kjo i lejon biznesit që ta zbresin TVSh-në e paguar në blerje.
- TVSh-ja hyn në tatimet në të cilat është shumë e vështirë mundësia e evazionit fiskal.
- TVSh-ja nuk favorizon përqendrimin vertikal midis ndërmarrjeve, d.m.th konsumi final të TVSh-ja gjithmonë është i ngarkuar njësoj pa marrë parasysh se në sa faza të qarkullimit ka kaluar prodhimi ose shërbimi.
- Mekanizmi i faturës tatimore inkurajon blerësit për të kërkuar faturë nga shitësi, duke parandaluar mos raportimin ose raportimin e ulët të shitjeve. Kjo siguron një sistem me efektiv dhe vetëm mbikëqyrës si dhe një raportim me të mirë të regjistrimeve kontabël për verifikim.

- Karakteristike tjetër është se numri i normave tatimore është i vogël dhe me shkallë normale tatimore.¹⁷

Ekzistojnë shumë elemente të tatimit mbi vlerën e shtuar, por kryesore janë këto: Objekti tatimor; Obliguesi tatimor ;Vendi i te tatuarit ; Baza tatimore; Normat tatimore dhe Përjashtimet tatimore

Rezultatet e aplikimit të TVSH-së

Analizat ekonometrike të kësaj çështjeje çojnë në disa rezultate :

- Ka evidence se prania e TVSh-së është shoqëruar me një përpjesëtim të lartë të të hyrave të përgjithshme të shtetit dhe grandeve në PPV (GDP), megjithatë efekti pozitiv i të hyrave është i shoqëruar me praninë e TVSh-së.
- Rezultatet e TVSh – janë po ashtu të lidhura ngushtë edhe me atë sesi funksionon ky tatim , cilët janë faktorët qysh nga kushtet e dizajnit të tatimit p. sh. definicioni preciz i bazës tatimore, shkalla standarde tatimore është një ndikim i madh në të hyra sepse çdo 1% rritje në shkallen standarde ngrit raportin e të hyrave të TVSh-së me konsumin privat në rreth 0, 6% në mesatare.¹⁸
- Rëndësia e tregtisë në një ekonomi po ashtu ka një shoqërim të madh pozitiv në rendimentin e TVSh-së, sa me e rëndësishme të jetë tregtia aq me tepër të hyra mund të mblidhen nga TVSh ekzistuese.
- Moshja e TVSh-së ka një efekt të madh pozitiv, atributet të konstruktit të TVSh-së përmirësohen me kohën.
- Arsimi po ashtu ka një shoqërim të fuqishëm pozitiv në rendimentet e TVSh- së.
- Shpesh është debatuar se TVSh është një tatim kompleks dhe kushton që të përmbushet dhe administrohet dhe si rrjedhojë nuk ka qene i përshtatshëm në vendet në zhvillim ose me nivele të ulëta të zhvillimit.

Tatimi mbi vlerën e shtuar në Kosovë

Tatimi mbi vlerën e shtuar apo TVSH-ja është një tatim mbi konsumin. Zbatohet në mallrat dhe shërbimet të kryera nga personi i tatueshëm në Kosovë dhe në importet dhe hyrjet nga ish-RFJ-ja.

Shkalla tatimore (përqindja) normale e TVSH-së është caktuar 16% (deri me 1 janar të 2009 ishte (15%) e vlerës së mallrave dhe shërbimeve të furnizuara dhe të sjella në Kosovë.

Po ashtu ekziston TVSH-ja me 0% në eksportet, Daljet drejt ish-RFJ-së dhe transportin ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve¹⁹.

¹⁷ Vladimir Sliejepeceviq, prof. – PDV prirucnik za svakoga, Dival, Zagreb, 1997,fq, 35

¹⁸ Desai, M. A & J. R. Hines, VAT and Internacional trade, The Evidence 2002, fq, 88

¹⁹ www.mfe-ks.org/old/Shqip/.../atatimore/.../lltatimeve/.../dorativsh.pdf

Funksioni i TVSH-së

Një pohim unik i bërë nga përkrahësit e TVSh-së është se ky tatim është një formë veçanërisht e suksesshme e tatimit. Për t'iu bindur këtij pohimi janë ofruar analiza të mjaftueshme dhe shpjegime për rezultatet e të hyrave të vendeve që aplikojnë TVSh dhe vendeve që nuk e aplikojnë TVSh?

Te ne në Kosovë Ju do të paguani 16% TVSH- në të gjitha blerjet tuaja të mallrave dhe shërbimeve nga furnizuesit e regjistruar. Ju po ashtu do të paguani 16% TVSH-në në të gjitha importet tuaja dhe hyrjet nga RFJ-ja .Si person i regjistruar i TVSH-së , i cili kërkohet të deklarojë, ju duhet të arkëtoni 16% TVSH nga konsumatorët tuaj në furnizimin e shumicës së mallrave dhe shërbimeve.

Këto quhen fuqizime të tatueshme. Eksportet dhe daljet nëpërmjet ish-RFJ-së janë, po ashtu furnizime të tatueshme , por tatimi mbi vlerën e shtuar në eksportet dhe daljet drejt RFJ-së është 0% dhe si pasojë shuma e tatimit në eksportet dhe daljet drejt RFJ-së do të jenë zero.

Në fund të çdo muaji ju do të plotësoni deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar. Deklarata i ka dy blloqe kryesore, njëra quhet tatimi i llogaritur dhe tjetra quhet **tatimi i zbritshëm**.

Ju nuk do të lejoheni të zbrisni TVSH-në e paguar në mallrat dhe shërbimet e marra për përdorim personal. Ju do të lejoheni të zbrisni tatimin e zbritshëm në mallra dhe shërbime të shfrytëzuara për qëllime biznesi. Furnizimet për biznese përfshijnë mallrat , sikurse janë makineria, mobiljet, ndërtesat apo shërbimet sikurse janë sigurimi, ndërtimi, pastrimi, kontabiliteti, ruajtja (mbrojtja)²⁰.

Nëse shuma e kombinuar e importeve, hyrjeve nga ish-RFJ dhe blerjeve në Kosovë të mallrave dhe shërbimeve është më e lartë se shuma e shitjeve, ju mund të jeni në pozitë të tatimit të paguar tepër (pozitë kreditore) dhe të lejoheni për rimbursim sepse, në atë rast, tatimi i paguar do të jetë më i lartë se tatimi i arkëtuar. Ju poshtu mund të lejoheni për rimbursim nëse keni eksporte apo dalje drejt RFJ-së ku shkalla e TVSH-së në këto raste është zero por ju lejoheni të kreditoni tatimin e paguar në blerjet, importet dhe hyrjet nga RFJ-ja

Subjektet e TVSh-së

Subjektet e TVSh-së janë :

- Importuesit dhe Eksportuesit
- Hyrjet nga ish-RFJ-së dhe daljet në ish-RFJ-së
- Bizneset me qarkullim mbi 50.000 € (Deklaruesit e TVSh-së)
- Deklaruesit Vullnetar të TVSh-së.

Regjistrimi për TVSh

²⁰ www.mfe-ks.org/old/Shqip/.../atatimore/files/.../Artikulli_Nr_9.doc Departamenti për Ndihmë dhe Edukim të Tatimpaguesve

Në qoftë se jeni importues a eksportues apo kryeni import, eksport gjatë kryerjes së një aktiviteti ekonomik, nga ju kërkohet të regjistroheni për TVSh-në në Administratën Tatimore, si dhe të pajiseni me certifikatën e TVSh-së pa marrë parasysh qarkullimin tuaj vjetor. Nëse qarkullimi vjetor i biznesit tuaj është më i lartë se 50.000€ nga ju kërkohet gjithashtu të regjistroheni si deklarues i TVSh-së.

Qarkullim për qëllime të regjistrimit për TVSh-së

Me “Qarkullim” nënkuptohet të hyrat bruto të të gjitha furnizimeve (shitjeve) të kryera nga një person në Kosovë duke përfshirë furnizimet e tatueshme në përqindjen normale tatimore 15%, furnizimet e tatueshme me përqindje tatimore 0%, dhe furnizimet e përjashtuara. Qarkullimi që do të llogaritet për qëllime të regjistrimit do të jetë qarkullimi brenda vitit kalendarik.

Tatimi i llogaritur

Tatimi i llogaritur është TVSh-ja që duhet ta aplikoni e mblidhni nga klientët tuaj në furnizimet tuaja të tatueshme të mallrave dhe shërbimeve.

Tatimi i Zbritshëm

Tatimi i Zbritshëm është shuma e TVSh-së së paguar në blerjet tuaja të mallrave dhe shërbimeve, si dhe importet që do të shfrytëzohen për aktivitete të tatueshme.

TVSh-ja e pagueshme

Ndryshimi pozitiv në mes të tatimit të zbritshëm përbën TVSh-në e pagueshme.

Regjistrimi për TVSh dhe pagesat

Pasi të jeni regjistruar person i tatueshëm Deklarues i TVSh-së dhe pasi të keni marrë numrin Regjistruar të TVSh-së ju duhet të aplikoni (mblidhni) TVSh-në në shitjet e tatueshme vendore të mallrave dhe shërbimeve. Çdo herë që të kryeni ndonjë furnizim (shitje) qoftë e tatueshme apo e përjashtuar, ju duhet të lëshoni faturë tatimore dhe ta regjistroni atë në librin e shitjes. Në anën tjetër ju lejohet për kreditim të tatimit të zbritshëm vetëm nëse keni marrë faturën tatimore nga furnizuesi juaj apo nëse i keni dokumentet e importit që në mënyrë të qartë tregojnë shumën e TVSh-së së paguar në blerjet tuaja. Deklarata e TVSh-së duhet dorëzuar deri në ditën e fundit të muajit që pason periudhën tatimore. Kjo deklarata dorëzohet në llogarinë e caktuar nga Administrata Tatimore në një bankë të licencuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës së bashku me pagesën e TVSh-së.

Kërkesa për regjistrimin e TVSh-së

Për tu regjistruar për TVSh-në, ju duhet të vizitoni Zyrat Tatimore Regjionale dhe Lokalet e Administratës Tatimore të Kosovës në vendndodhjen tuaj ku do të merrni një formular aplikacioni. Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, Administrata Tatimore do t'ua jap një numër të Regjistrimit të TVSh-së dhe një certifikatë regjistrimi si dhe Rregullore dhe Udhëzime që kanë të bëjnë me TVSh-në.

Baza ligjore për aplikim e TVSH

Politika tatimore në Kosovë është e orientuar drejt rregulloreve të thjeshta dhe të qarta me aspak ose pak përjashtime, të cilat sigurojnë një bazë të gjerë tatimore dhe parandalojnë evazionin tatimor.

Tatimi kryesor në Kosovë është TVSH-ja e cila është 16% për të gjitha mallrat, pa marrë parasysh originën e tyre dhe 0% për mallrat të cilat i dedikohen eksportit.

TVSH paguajnë ndërmarrjet të cilat kanë qarkullim vjetor mbi 50.000€ euro; ose kanë aset prej 50.000 €uro;.

Tendencat e Qeverisë së Kosovës janë që TVSH të aplikohet edhe për ndërmarrjet që kanë shkallë më të ulët të qarkullimit vjetor.

Për pajimet e importuara grace periudha (mundësia e pagesës) për pagesën e TVSH-së është 6 muaj. Është në përputhje me instruksionet e FMN, Direktivës së 6 te BE me të cilën rregullohet TVSH-ja ne UE. TVSH-ja ne Kosove aplikohet qe nga 1 korriku i vitit 2001. Për importet TVSH-ja mblidhet në kufijtë administrativë të Kosovës.

Brenda vendit TVSH-ja aplikohet për çdo furnizim të mallërave dhe shërbimeve, me përjashtim të atyre të cilat në bazë të ligjit konsiderohen si furnizime te përjashtuara. TVSH nuk aplikohet gjatë importimit të prodhimeve farmaceutike, instrumenteve kirurgjike dhe aparaturat mjekësore si dhe mallrat për qëllime humanitare. (Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/11 datë 31 maj, 2001, dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/17 datë 01 gusht Ndryshimet në Ligjin e tatimit mbi Vlerën e Shtuar)

Më 31/05/2001 nxirret edhe Udhëzimin Administrativ për implementimin e rregullores 2001/11, më këtë udhëzim sqarohen në mënyrë të zgjeruar, aplikimi i TVSH-s si nga ana e biznesit ashtu edhe për Administratën tatimore. Në këtë udhëzim paraqitet ana praktike të ilustruar me tabela dhe udhëzime për mbushjen e këtyre tabelave, për të gjitha rastet e mundshme. Për më tepër shiko në udhëzimin administrativ Nr. 2001/01

Më 1 Gusht 2002, bëhet rishikimi i Rregullores 2001/11 dhe nxirret rregullorja e re mbi TVSH-ë, (Për më tepër shiko Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/17 mbi ndryshimin e tatimit të vlerë së shtuar)

Më 1/09/2004 nxirret edhe Udhëzimin Administrativ për implementimin e rregullores 2002/17, më këtë udhëzim sqarohen në mënyrë të zgjeruar, aplikimin e

TVSH- si nga ana e biznesit ashtu edhe për Administratën tatimore. Në këtë udhëzim paraqitet ana praktike të ilustruar me tabela dhe udhëzime për mbushjen e këtyre tabelave, për të gjitha rastet e mundshme. (për më tepër shiko në udhëzimin administrativ Nr. 2001/04Më 25 Gusht 2004 dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/35)

Më 8 Gushtë 2005 bëhet ndryshimi I Rregullores 2001/11, nenin 13.2 b shlyhet, që i dedikohet organizatave joqeveritare mbi të drejtën e kthimit të TVSH-së ku me këtë rregullore i merret kjo e drejtë. (shiko Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/40)

Aktualisht baza legale e menaxhimit dhe e administrimit të TVSH është e mbështetur në Ligji Nr. 03/L-114, Datë 18.12.2008 - PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHITUAR e miratuar nga Kuvendi i republikës së Kosovës.

Shkallët tatimore dhe lirimet

Standard i njohur po thuaj se në të gjitha vendet e botës është që TVSh të ketë një shkallë (përveç shkallës zero vetëm për eksporte) por praktika tregon që sa me e vjetër që është TVSh-ja aq më shumë shkallë ka, dhe duke u varur nga vjetërsia numri i shkallëve është me i madh në Evropë.

TVSh është e dizajnuar të tatojë konsumin andaj lind pyetja pse një dëshire aq e fuqishme të tatohen komponentë të ndryshme të konsumit në shkallë të ndryshme e sidomos është e arsyeshëm që disa mallra jo elementare të tatohen në shkallë me të larta. Duke pasur parasysh rrethanat administrative në shumë vende të botës disa artikuj jo të domosdoshëm i nënshtrohen tatimeve më të larta si (alkooli, gazolina, prodhimet e duhanit).

Gjithashtu është e dëshirueshme që të tatohen me shumë ato mallra që llogariten si pjesë më e madhe e shpenzimeve për anëtarët me gjendje më të mirë në shoqëri. Ndryshe nga gjendja e vendeve të zhvilluara shumë vende në zhvillim nuk kanë të hyra të konsiderueshme nga tatimet në të ardhura që funksionojnë mirë si dhe program të shpenzimeve për të harmonizuar synimin e objektivave të barazisë në shoqëri p.sh edhe nëse popullata me standard të ultë në shoqëri harxhon proporcion me të madh të të ardhurave të tyre në disa artikuj të veçantë (ushqim) popullata me standard më të lartë zakonisht harxhon shuma më të mëdha absolute, kështu një ulje në shkallën tatimore në atë artikull në të vërtetë transferon më tepër para të pasurit sesa të të varfërit. Shtrohet pyetja për politikën tatimore në shumë vende në zhvillim se a është politikë më e mirë që të shkallëzohet tatimimi i të mirave apo që të aplikohet vetëm një shkallë e TVSh-së.²¹

Duke pasur parasysh se shkallëzimi TVSh-së krijon shpenzime për administrim dhe përmbushje shumica e vendeve të Botës aplikojnë një shkallë tatimore përveç shkallës zero (duke përfshirë edhe Kosovën) pjesa tjetër dy shkallë ndërsa një numër shumë më i vogël tri e më shumë shkallë.

Të gjitha vendet që aplikojnë TVSh-në janë të kujdesshme që të konstruktojnë lirime të kufizuara vetëm në disa fusha si shëndetësia, arsimi,

²¹ International Bureau of Fiscal Documentation (IBFD), Rome 2004, fq, 14 – 15.

shërbimet financiare por dokumentimi sistematik në fushë pothuajse në të gjitha vendet është i vështirë, shumëfishimi i lirimeve në TVSh në praktikë gjithnjë e më shumë është një brengë e përbashkët.

Lirimet në një mënyrë e shkelin logjiken e TVSh-së duke qenë në mes të vënies së shkallës pozitive të TVSh-së në mënyrë të zakonshme (duke tatuar shitjet dhe duke kredituar tatimin e zbritshëm) dhe shkallës zero (duke hequr krejt TVSh nga përfshirja në çmimin e produktit duke kredituar tatimin e zbritshëm, duke mos tatuar shitjet). Si rezultat, lirimet:

- 1) mund të paraqesin shkallëzimet të shoqëruara me shtrebbërime në prodhim - kur një mall i liruar ka hyrë si blerje në një mall tjetër TVSh-ja e përfshirë në mallin e liruar me herët në zinxhirin e prodhimit nuk mund të kërkohet si kreditim ;
- 2) bëjnë kompromis në parimin e destinacionit për artikujt e tregtuar ndërkombëtarisht – nëse një exportues porosit mallra të liruara në blerje exportet e atij exportuesi me shkallë zero do të përfshijnë TVSh-në qysh herët në zinxhirin e prodhimit ;
- 3) mund të krijojnë një avantazh konkurrues për importet mbi artikujt e liruar të prodhimit brenda vendit (meqë shkalla zero jashtë nënkupton se tatimi i zbritur është mbuluar në fillim) ;
- 4) në rastin e tregtarëve të liruar, krijon lehtësime për shmangien e detyrimit përmes integritit vertikal dhe në disa vende të zhvilluara ekziston një planifikim tatimor më agresiv dhe ;
- 5) nxit një dinamike përmes se cilës lirimet ushqejnë çdo rezultat tjetër që del nga lirimet - kur një sektor të marrë një lirim, ka një lehtësim të ndikojë që lirimet t'u jepen atyre nga të cilët i blejnë inputet (ashtu që të mbulojnë - paguajnë, TVSh- në e paguar në fazat e hershme të prodhimit)

Realisht, lirimet mund të paraqesin probleme dhe duhet të zbatohen disa rregulla për administrim:

a) caktimi i rregullave për inputet e tatuara janë të nevojshme për tregtarët që shesin si outputet e tatuara ashtu edhe ato të liruara, dhe

b) probleme të tjera dalin nga dëftesa dhe skemat e tjera që përdoren për të liruar (nga tatimi) projektet e asistencës financiare nga jashtë.

Duke analizuar këto vështirësi, pakësimi i lirimeve me gjasë do të jetë temë e shpeshtë në reformën e TVSh-së gjatë viteve në vijim. Po ashtu në frontin intelektual është mësuar shumë rreth alternativave praktike të lirimit në lidhje me sektorin publik dhe shërbimet financiare. Kështu që është nxitur vëmendje për këto shërbime në të gjitha vendet që aplikohet TVSh-ja . Në vitet e fundit Zelanda e Re ka adoptuar një shkallë zero për furnizimet nga ofruesit e shërbimeve financiare ku konsumatori është person i tatueshëm me se paku 75 % e shitjeve të tyre janë të tatueshme.²²

TVSH në vende të ndryshme dhe në Republikën e Kosovës

²² Konferenca e ITD-se mbi TVSh-në, Rome, Mars 2005,fq ,16 - 17

Vende të ndryshme në botë kanë shkallë të ndryshme dhe norma të ndryshme tatimore dhe atë secili vend në mënyre të pavarur duke ju përshtatur kushteve të tyre ekonomiko-sociale e përcakton kufiri dhe format e mbledhjes së takimeve përfshire edhe TVSH-në.

Sot në Botë numërohen 140 shtete që e aplikojnë TVSH-në dhe si i tillë bëjnë që ky lloj tatimi të jetë tatimi më i popullarizuar në Botë.

Vlen të ceket se si tatim është shumë i ri dhe i takon dekadave të fundit dhe atë si vijon:

Deri në vitet 1970	28 shtete
Deri në vitet 1980	48 shtete
Deri në vitet 1990	100 shtete
Sot (mbi)	140 shtete


Të gjitha vendet e zhvilluara dhe posaçërisht ato të BE së e shfrytëzojnë TVSH-në si tatimin kyç për mbushej e arkës shtetërore

Edhe shtete e rajonit tonë pra të Ballkanit e aplikojë TVSH si tatimin dhe atë duke filluar nga vitet e 90-ta.

Shteti	Viti i aplikimit te TVSH-se
Shqipëria	1995
Sllovenia	1999
Kroacia	1998
Maqedonia	2000
Kosova	2001

Sot, pra vende të ndryshme aplikojnë norma të ndryshme dhe përqindje të ndryshëm, po ashtu po paraqesim disa vende dhe përqindjet e tyre të TVSH-së

Nr	Shteti	TVSH ne %
1	Kosova	16
2	Bullgaria	20
3	Danimarka	25
4	Gjermani	19
5	Finlandë	25
6	Franca	19,6
7	BM	17,5
8	Italia	20
9	Austria	20
10	Suedia	25
11	Mali I Zi	17
12	IRJ e Maqedonisë	18
13	Shqipëria	20
14	Kroacia	23
15	Çeki	22
16	Spanja	16
17	Sllovakia	20
18	Luksemburgu	15
19	Malta	15
20	Polonia	22
21	Letonia	18



Krahasimi i shkallës së TVSH-së me vendet e tjera

Nëse e shohim tabelën lart atëherë mund të konstatojmë se Republika e Kosovës është një ndër vendet me shkallë më të ultë të TVSH përveç Luksemburgut që e ka 15 %.

Të gjitha vendet e rajonit e siç shihet më lartë në tabele dhe në paraqitjen grafike TVSH është me e lartë se në Kosove. Në Shqipëri vlera e TVSH –se është 20 % për mallra dhe shërbime.

Republika e Shqipërisë ka kategorizim të tatimeve që e bën me atraktiv tatimin pasi që disa lëmenj janë të përjashtuar kurse shumë produkte specifike kanë një tatim shtese

Pos rajonit po e krahasojmë edhe me Gjermaninë ku Vlera e shtuar e taksave në Gjermani është e vënë në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve në vend. Gjitha subjektet e biznesit janë subjekt i pagesës së tatimit mbi kryerjen e proceseve të prodhimit në Gjermani. Norma aktuale e TVSH-së në Gjermani është 19%, në fuqi nga 1 janari 2007. Në Gjermani, një taksë të reduktuar prej 7% është mbledhur nga shitja e sendeve të veçanta të tilla si ushqime, revistat dhe librat.

Norma e TVSH-së është vendosur në bazë të parametrave të sistemit të Bashkimit Evropian. Vendet e Bashkimit evropian e kanë të rregulluar se cilat produkte të listuara janë të përjashtuara nga TVSH-ja. Ndërmarrjet e biznesit duhet të paraqesin raportet e taksimit mujor dhe janë të detyruar të paguajnë taksat në bazë mujore, tremujore apo vjetore. Raportet gjithashtu përbëhen nga llogaritjen e taksave për tremujorin. Periudha e pagesave të taksave është i varur nga qarkullimi vjetor i kompanisë. Shuma për taksa paguhet paraprakisht në zyrën e taksave. Shumica e prodhuesve kanë shkallë të madhe janë të detyruar të dorëzojnë deklaratat e tyre mbi një bazë mujore.

Përfundime

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar si tatim indirekt edhe pse ka filluar të aplikohet relativisht vonë në sistemet tatimore, sot paraqet një prej formave më të rëndësishme tatimore në të gjitha shtetet bashkëkohore.

Dallimet kryesore të TVSh-së në krahasim me çdo lloj të tatimit mund të përmbledhen në këtë mënyrë: **1)** TVSh gjeneron të hyra me të mëdha tatimore, të cilat i arkëton pothuajse çdo shtet, **2)** TVSh ka baze të gjerë tatimore dhe prodhimi përcillet në të gjitha fazat e qarkullimit, favorizon prodhuesit dhe investitorët, **3)** TVSh përfshin një numër me të madhe të tatimpaguesve, **4)** TVSh është e mbrojtur nga evazioni fiskal, **5)** TVSh funksionon me metodën e zbritjes dhe teknika e llogaritjes dhe arkëtimit ndikojnë në evitimin e të tatuarit të dyfishtë të qarkullimit të mirave dhe shërbimeve në të gjitha fazat e qarkullimit, **6)** TVSh stimulon eksportin, **7)** TVSh lehtëson funksionimin e suksesshëm të sistemit tatimor.

Qëllimi i tatimit mbi vlerën e shtuar është se me këtë tatim ngarkohet vetëm qarkullimi i cili i shërben konsumit final. Parimisht tatohet çdo qarkullim mirëpo baza tatimore zvogëlohet për shumën e tatimit të zbritshëm. Për këtë arsye TVSh

nuk ngarkon qarkullimin e tërësishme por vetëm vlerën e shtuar të cilin e paguan konsumatori i fundit që është konsumuesi privat (qytetari) dhe konsumuesi publike (shfrytëzuesit e buxhetit). Qëllimi i pagesës së këtij tatimi nga konsumatori i fundit është edhe i tatimit në qarkullim por ai qëllim nuk është çdoherë i suksesshëm si TVSh ngase tatimi në qarkullim shpesh herë futet në mënyrë të padukshme në çmimin e të mirave dhe shërbimeve dhe në mënyrë të pabarabartë i ngarkon ato, kjo nuk ndodh në tatimin mbi vlerën e shtuar.

Politikat fiskale apo direkt kufiri i TVSh-së është një ndër fazat kritike në konstruktin dhe implementimin e këtij tatimi pothuajse për çdo shtet. Kufiri i ulët për shumë vende nuk ka sjellë shumë vështirësi sidomos në fillim të aplikimit të TVSh-së.

Administrimit i TVSh -së është i lidhur ngushtë me një vendim të rëndësishëm se a duhet administrimi i TVSh-së të jetë përbrenda administratës tatimore apo të ndonjë autoriteti tjetër të të hyrave. Pothuajse në të gjitha vendet që bëjnë vjeljen e tatimeve në importe duke përfshirë edhe TVSh është përgjegjësi e departamentit të doganave. Por pavarësisht administrimit është e nevojshëm të ketë koordinim të ngushtë të përgatitjeve të TVSh-së në mes të administratës tatimore dhe departamentit të doganave.

Si rrjedhë logjike dhe shkencore janë tri mundësi të administrimit të TVSh-së;

- a) Administrimi i TVSh-së nga autoritete tatimore së bashku me administrimin e tatimeve të tjera,
- b) Administrimi nga një departament i ndare për TVSh dhe ,
- c) Administrimi nga departamenti i doganave.

Administrata tatimore e Kosovës merret me administrimin e TVSh-së së brendshme dhe administrimin e tatimeve qendrore qeveritare të cilat përfshijnë: Tatimi në të Ardhura e Korporata, Tatimin në të Ardhura Personale dhe Kontributet Personale , ndërsa Shërbimi doganor i Kosovës administron TVSh-në në importe .

Ky tatim (TVSh) në Kosovë është identifikuar si shtylla kryesore e të hyrave dhe do të jetë në të ardhmen, është shumë e rëndësishme për stabilitetin fiskal në Kosovë, dhe në masë të madhe është kompatible me BE, e lehtë për export dhe investime. Aplikimi i TVSh-së në Kosovë në vitin 2001 ka siguruar zvogëlimin e vartësisë së Kosovës nga donacionet, dhe ka paraqitur një burim të sigurt të të hyrave që njëkohësisht zvogëlon edhe vartësin nga tatimet kufitare. Momentalisht Kosova aplikon TVSH me masën 16 %.

Legjislacioni tatimor i Kosovës është i njohur si nga FMN-ja ashtu edhe Komisioni Evropian si legjislacion transparent dhe me standarde ndërkombëtare të mira. Legjislacioni i TVSh-së në masë të madhe plotëson kërkesat e Direktivës së Gjashtë të BE-së dhe ky fakt është një ndër përparësitë me të mëdha në këtë legjislacion.

Rendësinë ia shton kur e ke parasysh se TVSh pothuajse në të gjitha vendet që aplikohet ashtu edhe në Kosovë është një ndër tatimet me më peshë për arkën shtetërore.

Disa nga përparuesit e TVSH-së në Kosovë janë:

1. Norma standarde 16% dhe zero përqindje, e cila është me funksionale për administrim sesa normat e shkallëzuar .
2. Exporti tatohet me shkallen zero përqindje që është përparësi për prodhimin e vendit.
3. TVSh është tatim që bartet dhe paguhet nga konsumatori, ndërsa personat e tatueshëm e mbledhin (agjentë) që është një nga faktorët kryesorë të mos stimulohet evazoni fiskal.
4. Faturimi sepse nëpërmes faturimit shfrytëzohet TVSh e zbritshme, nëpërmes dokumentacionit aprovohet kreditimi në raste të caktuar.
5. Listat e përjashtimeve gjithashtu janë përparësi, sepse mundësojnë që të lirohet buxheti i konsumatorit nga disa ngarkesa.

Mirëpo, ky tatim (TVSh) na paraqet edhe disa mangësi apo të meta që mbetet të ndryshohen në të ardhmen.

1. Kufiri prej 50,000.00€ i regjistrimit është shumë i lartë dhe mundëson që një numër shumë i madh i bizneseve të jetë jashtë këtij kriteri dhe ky limit e shpëton zinxhirin e TVSh, kjo mundëson evazion fiskal duke iu mundësuar shumë bizneseve lëshimin e faturave pa TVSh.
2. Përdorimi i arkave fiskale do të ishte një rregullator i furnizimeve të tatueshme, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi personat e tatueshëm janë të obliguar që transaksionet e tyre t'i regjistrojnë në makinat elektronike dhe konsideroj se mosaplikimi i këtij sistemi është një e metë shumë e madhe .
3. Kërkesa për rimbursim rikthim, shqyrtohet për një afat shumë të gjatë 60 ditor.
4. Procesi i regjistrimit për TVSh duhet të jetë me efektiv dhe të na ofrojë një siguri me të madhe për parandalimin e mashtrimeve në drejtim të TVSh-së
5. Listat e përjashtimeve duhet të jenë me të specifikuar
6. Borxhi i keq duhet të trajtohet në mënyre të kujdesshme dhe kërkon një kujdes me të veçantë nga institucionet e shtetit Gjykatat dhe ATK
7. Të gjitha transaksionet e personave të tatueshëm duhet të bëhen nëpërmes sistemit bankare.

Referencat

1. Indirect Tax Evazion and Production Efficiency, JP Economics, vol 39,1989
2. Sabaudin Komani/ Financa Publike, Universiteti i Prishtinës 2008
3. Bozhidar Jelqiq /Finansisjko pravo i finansisjka znanost / Zagreb, 1997
4. Artan Nimani/Politikat financiare- me vështrim Kosova/ISRN-KUB Prishtinë 2010
5. Branko Svilar / VSE o DDV, Oziris, Lesce, 2001
6. David Williams/VALUE–Added TaxInternational Monetary Fund, Washington1996

7. Doracak për tatimin mbi vlerën e shtuar ne Kosove, Prishtine, 2007
8. Barbara Jelqiq / Javne financije , Informator, Zagreb, 1998
9. Kasem Seferi/ Kontrolli tatimor, Tiranë 2006
10. Konferenca e ITD-së mbi TVSH-ne , Romë, 2005
11. Ligji -1995, dhe udhëzimet, për zbatimin e tatimit mbi vlerën e shtuar në Shqipëri
12. Materiale nga Instituti Kosovar për të drejtën e OJQ-ve
13. Materiale nga Aplikimi i tatimeve te konsumit mbi tregtinë në shërbimet dhe gjerat e patrupëzuara ndërkombëtare (OECD), 2004
14. Materiale nga MEF & ATK, Instituti për hulumtime RIINVEST
15. Mario Leccisotti – Leksione të shkencës se financave, Tiranë, 2000
16. Artan Nimani/ Menaxhimi i Financave Publike/ ISRN Prishtinë 2007
17. Sabri Kadriu, Financimi publik ne Kosove, Sabrico, Prishtine 2002
18. Sotiraq Dharmo, Kontabiliteti. financiar, Grevis, Tirane, 2000
19. The modern VAT, Materiale nga FMN
20. Udhëzimi administrativ 05/200, Udhëzimi administrativ 01/2004
21. VAT and Internacional trade - The Evidence, 2002, Desai, M. A& J. R. Hines
22. Vladimir Slijepčević, prof – PDV priručnik za svakoga, Dival, Zagreb, 1997
23. Zakon za DDV, R. Makedonija
24. <http://www.itdweb.Org>. 2006/02
25. <http://www.atk-ks.org/Shqip/fillim/2010>
26. Rregullore nr 2005/40,për ndryshimin Rreg UNMIK nr.2001/11 mbi T Sh në Kosovë
27. Ligji Nr. 03/L-114, Datë 18.12.2008 - PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR
28. Rregullore nr. 2001/11 - Datë 31.V.2001 - për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar
29. Rregullore nr.2001/41-Ndryshimi rreg së UNMIK-ut nr 2001/11 për TVSh në Kosovë
30. Udhëzim Administrativ nr. 01/2004 - Datë 1 shtator 2004 -për zbatimin e TVSh
31. Udhëzim Administrativ nr. 01/2001 - Datë 05/31/2001-Për zbatimin e TVSh
32. Rregullore nr.2001/17- Ndryshimi i rregullores 2001/11 Tatimin mbi Vlerën e Shtuar